



BASHKIA TIRANË

NJËSIA ADMINISTRATIVE KRRABË

Nr. ____ .prot

Krrabë më ____/____/2017

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot më datë 23.11.2017 mbi dëgjesën publike për buxhetin e vitit 2018. Në takim ishin të pranishëm Administratori i Njesisë Administrative Krrabë, Z.Alfred Brahja , Z. Erind Bejko, Drejtor në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi , Koordinimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, kryetarët e fshatrave si dhe banorë të kësaj Njësie.

Administratori i Njesisë Administrative Krrabë, Z.Alfred Brahja, pasi falenderoi pjesmarrësit për pjesmarrjen dhe interesin për zhvillimin e këtij takimi të rëndësishëm, bëri një përmbledhje të investimeve të kryera në Njësinë Administrative Krrabë.

“Njësia Administrative ka një shtrirje rreth 18 km² dhe një popullsi prej 3125 banorësh. Në njësinë tonë janë kryer investime dhe bashkëpunime me institucione të ndryshme, ku vlen për t’u përmendur :

- Rikonstruksioni i rrugës Mushqeta-Krrabë;
- Rikonstruksioni i njëres prej rrugëve të brendshme të fshatit Mushqeta;
- Hapjen e një rruge të re që lidh fshatin Skuterë me qendrën e Krrabës;
- Ndërtimi i një kanali kullues në fshatin Mushqeta;
- Zëvendësimi i rrjetit elektrik të qendrës së Krrabës nga tela alumini me kabëll duke shmangur plotësisht problemet e mëparëshme të shkaktuara nga takimi i telave në mot me erë;
- Krijimi i stacionit të autobuzëve;
- Rregullimi i orareve të autobuzëve;
- Ulja e çmimit të biletës.
- Bashkëpunimi me Alb-miniera për procesin e pajisjes me çertifikatë të banorëve që banojnë në pallatet e ish minierës;
- Kërkesa drejtuar Autoritetit Rrugor Shqiptar për krijimin e një pike hyrje-dalje në autostradën Tiranë-Elbasan për Njësinë Administrative Krrabë.

Prioritetet për vitin 2018 i janë dërguar në kohë Drejtorisë së Objekteve në Bashkëpronësi , Koordinimit me Njësitë Administrative dhe Emergjencave Civile (DOBKNjAEC), për realizimin e të cilave po i jap fjalën z.Erind Bejko.”

Z. Erind Bejko, Drejtor në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, falenderon pjesëmarrësit dhe shprehet se: “Kjo është një dëgjese, ku ne do dëgjojmë kërkesat tuaja në lidhje me investimet për këtë vit krahas këkesave të dërguara nga administratori i njësisë.

Gjatë vitit 2017 nga Bashkia e Tiranës edhe në Njësine Administrative Krrabë janë kryer investime ku vlen për tu përmendur:

- Rikonstruksioni i rrugës Mushqeta-Krrabë, i cili u krye falë këmbëguljes dhe punës së administratorit Z. Brahja me qëllim lehtësimin e komunikimit të banorëve të Krrabës.
- Gjithashtu u bë i mundur edhe rikonstruksioni i njërës prej rrugëve të brendshme të fshatit Mushqeta.

Pa u zgatur më tej për investimet tashmë të kryera, për vitin e ardhshëm bashkia e Tiranës do të bëjë këto investime:

- Pastrimin e mbetjeve, dhe për këtë qëllim tashmë është lidhur kontrata e re për pastrimin dhe duke qenë se nuk ka ankesa nga operatorët pjesëmarrës në këtë procedurë kontrata do të nisë nga zbatimi brenda 10 ditësh;
- Do të bëhet rehabilitimi i qendrës së Krrabës duke bërë edhe restaurimin e pallateve, gjë që rrit vlerën e apartamenteve nga 10-20%.
- Do të ndërhyet në ndriçimin publik duke bërë të mundur përmirësimin dhe zgjerimin e tij;
- Kryetari i bashkisë Tiranë i ka bërë kërkesë Autoritetit Rrugor Shqiptar për lidhjen e Njësive Administrative Krrabë me autostradën Tiranë-Elbasan;
- Do të bëhet rikonstruksioni i shkollave, kopshteve dhe rregullimi i lulishteve nga Drejtoria e Punëtorëve numër 3;
- Do të ketë punime tek ujësjellësi me qëllim furnizimin e të gjithë banorëve me ujë.

Diskutimi vazhdoi në formën e një bashkëbisedimi, ku u shprehën opinionet dhe kërkesat e pjesëmarrësve për vitin 2018.

Qytetari I

“Duke shprehur vlerësimin për punën e kryer deri tani do të doja të paraqisja dy kërkesa lidhur me dy probleme ende të pa zgjidhur.

E para, problem i madh janë mungesa e kazanëve të mbeturinave dhe se ato që janë, janë të dëmtuar shumë.

Dhe e dyta, toka në parcelën e varrezave të Krrabës po shkon drejt zënies së plotë dhe në një të ardhme të afërt nuk do të ketë më vend ku të varrosen banorët e zonës.”

Fillimisht këtyre kërkesave iu përgjigj Z. Bejko duke thënë se problemi i koshave tashmë është i zgjidhur nga kontrata e re e pastrimit që është lidhur dhe siç u përmend edhe më parë fillon nga zbatimi brenda 10 ditësh.

Në lidhje me zgjerimin e parcelave të varrezave, kjo është kompetencë e bashkisë dhe ndjekja e procesit të shpronësimit për zgjerimin e tyre në pronë private ndiqet në bashkëpunim me administratorin e njësisë.

Pas Z.Bejko, administratori i njësisë Z.Brahja bën me dijeni se problemi i varrezave po ndiqet nga njësia administrative prej rreth dy viteve për krijimin e dy parcelave të varrezave në fshatin Skuterë dhe Mushqeta, dhe zgjerimi i varrezave të Krrabës.

Qytetari II

“Meqenëse një pjesë e problemeve që kisha u sqaruan nuk po i përsëris , por mbetet ende problem rruga e lagjes Zall e fshatit Skuterë pasi është e amortizuar. Gjithashtu problem madhor ka edhe me ujësjellësin e lagjes sepse rrjeti është i amortizuar dhe uji i tij është i ndotur.”

Në përgjigje të këtyre problemeve administratori i njësisë administrative , Z.Brahja shprehet se për problemin e rrugës po bashkëpunohet me Ndërmarrjen Numër 2 , e cila tashmë ka në dispozicion mekineritë e nevojshme për riparimin dhe asfaltimin e segmenteve të shkurtër rrugor, në të cilin mund të përfshihet edhe rruga Krrabë-Skuterë. Ndërkohë Bordit të Kullimit i është bërë kërkesë për ndërtimin e një kanali kullimi, i cili do të mbledhë ujërat e zeza dhe ujërat e shirave në mënyrë që të mos përfundojnë në burimin e ujit duke e ndotur atë.

Kemi edhe një projekt-ide për shfrytëzimin e një burimi uji pranë tunelit të autostradës, i cili do të furnizonte me ujë rreth 40% të konsumatorëve të njësisë, dhe për këtë po bashkëpunojmë me UKT.

Qytetari III

“Problem tjetër që na shqetëson është edhe vonimi i legalizimeve të banesave tona.”

Në lidhje me këtë problem përgjigjia ishte e njëjtë si nga administratori ashtu edhe nga Z.Bejko duke thënë se kjo nuk është kompetencë e bashkisë së Tiranës.

Në vijim të diskutimit, kryetarët e fshatrave Skuterë dhe Mushqeta ritheksojnë edhe një herë rëndësinë e zgjidhjes sa më të shpejtë të problemeve të shprehura nga banorët për të shmangur dëmet që këto probleme mund të shkaktojnë.

Krahas kësaj, kryetari i fshatit Mushqeta ngriti shqetësimin se në këtë fshat mungon tërësisht ndiçimi publik dhe se së paku duhej të bëhej ndriçimi i zonave të banuara.

Gjithashtu nevojitet vendosja e një transformatori për këtë fshat sepse ka probleme të vazhdueshme të furnizimit me enegji elektrike të tij.

Për këtë problem Z.Bejko shprehet se vendosja e transformatorit nuk është kompetencë e bashkisë, ndërsa për ndiçimin publik u shpreh më herët gjatë takimit.

Ndërkohë Z.Brahja bëri me dije se problemi për nevojën e vendosjes së transformatorit është ndjekur prej tij dhe i është bërë kërkesë OShEE, por për arsye burokratike nuk është bërë i mundur.

Për zgjidhjen e tij po vazhdon ende komunikimi me OShEE dhe po bëhen përpjekje që ky problem të zgjidhet sa më shpejt.

Pas këtyre përgjigjeve administratori i njësisë, Z.Brahja dhe drejtori i DOBKNjAEC, Z.Bejko, pyetën pjesmarrësit nëse kishin kërkesa të tjera.

Duke qenë se pjesëmarrësit e tjerë nuk kishin më kërkesa të tjera, Z.Brahja dhe Z.Bejko falenderuan pjesmarrësit dhe mbyllën takimin.

Mbajtësi i procesverbalit

Specialist

Agim Gapi

ADMINISTRATORI

Alfred Brahja